



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.985/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Automatics –Ks SH.P.K, me NUI:811186560, me seli në Gjilan, rruga “Abdullah Tahiri”, kundër debitorit Kosova Water and Energy SH.P.K, me NUI:810196437, me seli në Mitrovicë, rruga “Shkumbini” nr.62 të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Taulant Hajdari, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2560/22 të datës 09.06.2023, me datë 20.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Kosova Water and Energy SH.P.K, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2560/22 të datës 09.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2560/22 të datës 09.06.2023, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Kosova Water and Energy SH.P.K me seli në Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit me numër P.nr.653/22 të datës 24.10.2022 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa në Gjilan.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori përmes të autorizuarit të tij, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave procedurale. I ka propozuar gjykatës që ankesa e parashtruar të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2560/22, i datës 09.06.2023, dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Musa.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Automatics –Ks, me seli në Gjiilan, me datën 24.10.2022, ka paraqitur propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me nr.32 e datës 01.09.2022, duke kërkuar nga debitori Kosova Water and Energy sh.p.k, me seli në Mitrovicë që t'ia paguaje borxhin në shumën prej 28,738.29 €, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Përmbareuesi Privat Kushtim M. Musa në Gjiilan, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me Urdhrin përmbaremore P.nr.653/22 të datës 24.10.2022, e ka lejuar përmbaremoren e propozuar nga kreditori.

Kundër këtij urdhri në afatin ligjor ka ushtruar prapsim debitori përmes të autorizuarit të tij avokatit Taulant Hadari nga Prishtina. Në prapësim ndër të tjera ka theksuar se faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit dhe nuk janë të vulosura nga ana e debitorit. Po ashtu ka theksuar se në lidhje me pretendimet e tij kreditori duhet të inicioi procedurë kontestimore. Ka propozuar që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbaremore P.nr.653/22 i lëshuar nga Përmbareuesi Privat Kushtim Musa.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapsim ndër të tjera ka theksuar se nga debitori ka kërkuar kompensimin e borxhit, mirëpo debitori asnjëherë nuk e ka paguar borxhin. Procedurën përmbaremore e ka iniciuar në bazë të faturës e cila i plotëson kushtet ligjore sipas Ligjit për Procedurën Përmbaremore. Ka shtuar se pretendimet e debitorit në prapsim janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj. Po ashtu nuk ka ofruar asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Komerciale –Shkalla e Parë, Dhomat e shkallës së parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, prapësimin e kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2560/22, të datës 09.06.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Kosova Water and Energy me seli në Mitrovicë, i ushtruar kundërt Urdhrit për lejimin e përmbaremit me numër P.nr.653/22 të datës 24.10.2022 të lëshuar nga Përmbareuesi Privat Kushtim M. Musa në Gjiilan. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbaremore, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet nga neni 29 dhe 37 të LPP-së. Urdhri lejuar i përmbaremit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht faturën nr.31 dt.01.09.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e

dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së,. Fatura është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes postës, e cila vërtetohet nga fletë kthesa e postës datës 18.10.2022, e cila mban nënshkrimin e debitorit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e tillë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar edhe gjendja faktike, shkelje të cilat Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore të palës debitore, të njëjtat i refuzoj si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: *“ Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar ”.*

Fatura me nr.32 e datës 01.09.2022 e kreditorit, paraqet dokument të besueshëm, është i përshatshëm për përmbartim dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par.1 pika 1.3 dhe par.3 e lidhur me nenin 40 par.1 pika 1.3 të LPP-së për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshatshëm për përmbartim. Kjo fature është paraqitur në origjinal bashkangjitur propozimit për përmbartim, po ashtu janë te treguara palët, përkatësitë kreditori dhe debitori, janë të përshkruara produktet-shërbimet te cilat kanë qene objekt i faturës, është e përcaktuar shuma e detyrimit për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes, është e dorëzuar në origjinal dhe është pranuar përmes postes nga debitori me datën 18.10.2022.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura”.* Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoj pretendimet e debitorit se fatura në fjalë nuk është e pranuar nga personi i autorizuar nga debitori, mirëpo kjo gjykatë këto pretendime i vlerësoi si të pabazuara, me arsyetimin se pas pranimit të produkteve-shërbimeve është lëshuar fatura në fjalë e vulosur e cila është pranuar nga debitori përmes postes.

Përfundimisht Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka Refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur ndaj propozimit për përmbarim, sepse pretendimet në prapësim ishin të pabazuara dhe të pa mbështetura në shkresa të lëndës, dhe se pala debitore nuk ka ofruar prova për të mbështetur pretendimet e tij në kuptim të nenit 71 dhe 69 të LPP-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.985/24 me datë 20.01.2025

Gjyqtari,  
Krenar Berisha